




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	12.05.2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMARK	2381/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 204/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 204/2021 të datës 31.03.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Dobratin, Komuna e Podujevës, kundër Thesarit të Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, di dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të datës 12.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.Nr.204/2021 e datës 31.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 31.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1503/2021 të regjistruar me numër A.nr.204/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes së Zyrës Ligjore të Thesarit të Kosovës të datës 01.03.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 27.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Thesari i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 30.04.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1503/2021 të datës 31.03.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.04.2021; Kërkesë për kthimin në vendin e punës me nr. protokolli 132 i datës 13.01.2021; Përgjigjen ndaj kërkesës nr.132 e datës 01.03.2021; Vërtetimin e Marrëdhënies së Punës të datës 08.08.2015; Vërtetimin me Nr.13-113/01-76596/20 nga Zyra e Personelit i datës 17.12.2020; Përgjigjen në ankesë të datës 30.04.2021; Kontrata e Marrëdhënies së Punës e datës 30.03.2007; Përshkrimin e Detyrave të Punës; E-mail nga S.B. për C.Z. i datës 06.05.2021; E-mail nga M.G. për I.L. i datës 02.03.2021; E-mailin nga S.B. për C.Z. i datës 06.05.2021; Kontratën e Punës prej datës 22.07.2003 deri 22.07.2004; Kontratën e Punës prej datës 22.07.2004 deri 22.07.2005; Kontrata e Marrëdhënies së Punës prej datës 22.07.2005 deri 30.06.2006;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankuesit ne numër A.nr.204/2021 e datës 31.03.202, është pa bazuar, sepse:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar së ankuesi ka qenë i punësuar në Departamentin e Thesarit (tani Thesari i Kosovës), në Ministrinë e Financave, në pozitën e "Zyrtarit të Tavolinës Ndihmëse" nga data 15.06.2003 deri me datë 02.02.2010, gjegjësisht deri në zgjedhjen e tij Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Podujevës. Sipas Vërtetimit nr.13-113/01-76596/20 të datës 14.12.2020 të lëshuar nga Komuna e Podujevës ankuesi detyrën e Drejtorit për Buxhet dhe Financa e ka ushtruar për tri mandate radhazi dhe atë nga data 01.02.2010 deri 03.01.2014 , 05.02.2014 deri 20.12.2017 dhe 25.01.2018 deri 29.11.2020.

Pas përfundimit të mandatit të tretë, ankuesi me datë 19.01.2021 i është drejtuar më kërkesë Thesarit të Kosovës, për kthimin e tij si nëpunës civil në Thesarin e Kosovës. Në përgjigje të kërkesës së ankuesit, Zyra Ligjore e Thesarit të Kosovës me datë 01.03.2021 ka njoftuar ankuesin se i njëjti nuk mund të kthehet në vendin e tij që ka ushtruar në Thesarin e Kosovës, me arsyetimin se në kohën e emërimit të tij në postin publik të Drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Podujevas, ka qenë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2 -Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas të cilave me emërimin e një nëpunësi në një post publik konsiderohet i dorëhequr dhe humb statusin e nëpunësit civil.

Kundër përgjigjes së datës 01.03.2021 të Zyrës Ligjore të Thesarit të Kosovës, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit 03/L-212 të Punës si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Propozon që Këshilli ta hedhë poshtë si të pa bazuar Përgjigjen e Zyrës Ligjore të Thesarit të Kosovës të datës 01.03.2021 si dhe në raport me ankuesin të vlejné dispozitat e Ligjit për Shërbimin civil dhe Ligjin për Zyrtaret Publik, ashtu qe ankuesin ta kthej në vendin e punës Zyrtar i Tavolinës Ndihmëse apo në ndonjë vend ekuivalent në Thesarin e Kosovës.

Kolegji nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se në kohën e emërimit të ankuesit Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Podujevës, ka qenë i aplikueshëm legjislacioni i UNMIK-ut respektivisht Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me 25.01.2003 dhe ka qenë e zbatueshme deri me 10.07.2010 respektivisht deri me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 204/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit të Thesarit të Kosovës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

